



UNIVERSITETI I GJILANIT "KADRI ZEKA"

"KADRI ZEKA" UNIVERSITY OF GJILANI

Rr. "Zija Shemsiu", 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Retor

Pof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Fjalimi i Rektorit Kosumi në hapje të DIGI CONFERENCE

Në organizim të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan (UKZ), në bashkëpunim me:

Universiteti i Montengeros, Podgoricë, Mali i Zi – Dr. Irena Orović

Universiteti i Korçës "Fan S. Noli", Shqipëri - Dr. Arto Adili, Dr. Rafail Prodani

Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani", Shqipëri - Dr. Bederiana Shyti, Dr. Rexhep Rada

Universiteti "Nënë Tereza", Shkup, Maqedoni Veriore - Dr. Bekim Fetaji

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemajli", Shqipëri - Dr. Eva Çipi

Universiteti i Mitrovicës, "Isa Boletini", Kosovë - Dr. Fitim Zeqiri, Dr. Muzafer Shala

Te pranishmit ne sesionin e pare:

Erëin Brategeyer, Universiteti i Danubit Krems, Austri

Blerim Rexha, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Erind Bedalli, Universiteti i Elbasanit, Shqipëri

Artan Dërmaku, Universiteti "Kadri Zeka", Kosovë

Bekim Fetaji, Universiteti "Nënë Tereza", Maqedoni

Të nderuar të pranishëm,

Ka gjasa që teknologjia digjitale është shpikja më e madhe në historinë e njerëzimit. Teknologjia e informimit sot është promotori dhe gjeneratori kryesor i zhvillimit ekonomik. Ato që kanë qenë fabrikat për shekullin XIX-XX është kompjuteri për shekullin XXI.

Digjitalizimi i dijeve, i përvojës dhe inteligjencies njerëzore është hap I madh drejt njeriut të shumë dijshëm.

Disa popuj e disa kultura kanë ecur përpara në këtë drejtim. Në Kosovë dhe në kulturën shqiptare ka një ngecje, dhe kjo ngecje është paradoks më vete. Statistikat tregojnë se përqindja e kosovarëve që kanë qasje në internet është ndër më të lartat në Europë-ndërsa në anën tjetër digjitalizimi i proceseve kulturore, ekonomike dhe inxhinierike është një hap prapa.

Pse ndodh ky paradoks nuk ka një përgjigje. Por, ka gjasa që një ndërlidhje më e mirë e procesit akademik-inxhinierik dhe biznesor ta ndryshojë këtë paradoks. Studimet akademike nuk janë qëllim në vetvete, po, si thuhet në Strategjinë Zhvillimore të UKZ “...janë në shërbim të dijes, të edukimit dhe të mirëqenies së shoqërisë kosovare dhe të mbarë njerëzimit.”

Misioni I UKZ është: “Të përgatisë të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të qenë pjesë e një shoqërie modern dhe globale, pjesë e një tregu më të gjerë se sa tregjet tradicionale të punës dhe njëkohësisht, model për anëtarët e tjerë të shoqërisë sonë.”

Ne në UKZ besojmë në këtë mision. Nëse është kështu, atëherë duhet t’i qasemi shumë seriozisht procesit të digjitalizimit, sepse tregu botëror është në shumë raste I digjitalizuar; dija dhe shkenca është e digjitalizuar; prodhimi është I digjitalizuar.

Është edhe një faktor tjetër themelor te teknologjia digjitale: koha.

Teknologjia digjitale e ka dinamizuar kohën për miliona herë më shumë. Në hap me këtë dinamizim duhet të jenë edhe përgjigjet tona për digjitalizimin e kulturës, të ekonomisë e të dijeve tona. Nuk mund të ketë një përgjigje të vonuar, sepse teknologjia digjitale ndryshon aq shpejt sa që asnjëherë nuk mund ta zëmë hapin me të. Prandaj përgjigjet tona në të gjitha çështjet që shtrohen për digjitalizimin duhet të jenë të shpejta. Shumë dinamike, për të qenë së pakut afër të njëjtave procese kudo në botë.

Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni të ju dëshiroj sukses në këtë konferencë, uroj që të shtroni problem dhe të diskutoni rreth tyre, pse jo edhe të ofroni zgjidhje. Më së shumti uroj studentët të cilët do të paraqesin projektet e tyre. Asnjëherë më shumë nuk ka pasur kuptim fjalia “e ardhmja I takon rinisë” në kontekstin e teknologjisë digjitale. Me të vërtetë dallimi I dy gjeneratave të sotme, asaj paradigjitale dhe digjitale është dallim shekullor edhe pse që t dyja e jetojnë të njëjtën kohë, I ngjashëm me dallimin midis shtypshkronjës së Gutenbergut dhe tekstit digjital.

Dua ta mbyll fjalën time me një fjali të Umberto Ekos, I cili thoshte se ishte më se I lumtur që në tavolinën e tij të punës, në kompjuter, mbante disa biblioteka gjigante.

Edhe unë ndjejë të njëjtën kënaqësi.

Urime!

Gjilan, më 30.05.2019